

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Apple i jep Tim Cook 47 milionë dollarë për të qëndruar në kompani - Business Magazine Albania
ADRESA	https://businessmag.al/apple-i-jep-tim-cook-47-milione-dollare-per-te-qendruar-ne-kompani/
BURIMI	businessmag.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 14:51:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 07:04:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e6311231b53bd13e9aa207838ab1ddf446ff662713aba27ae54448bd268c8173
TEKSTI	a2483c27ebb3842408818cbbce2dec6b443f05b8567079930b4435841511c653
PAMJA	f0bd1f49133b30952473b08d8a9b9c2f0644c59e2ffdd5e1dc691ca71963ab6c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc2ba1050929b2f1bafaa676771016731fd9273450f493c18ab951d3f96eb141
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bb4e79b3ec69077edf87697d0c7be1f8024ce2653cdf443ef98b2b2b16c0a234
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47169057
TRANSAKSIONI	0xc53d1d83eb5113e27101883e7ec1c599aedef807da486e98a6185fca192c6367
IPFS	QmVM2yPqKgDMM4oCMYr6dnZ3RqmeCHegWHRJZJGnzkgCiv



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc2ba1050929b2f1bafaa676771016731fd9273450f493c18ab951d3f96eb141>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Apple i jep Tim Cook 47 milionë dollarë për të qëndruar në kompani

TEKNOLOGJI

Publikuar: 04/09/2026

695



Eni Muça

Share

+ Businessmag Extension



Tim Cook nuk është më CEO i Apple, por roli i tij i ri në kompani do të vazhdojë të shoqërohet me një paketë kompensimi të nivelit të drejtuesve më të lartë. Pas 15 vitesh në krye të gjigantit të teknologjisë, Cook ia dorëzoi drejtimin e kompanisë John Ternus, ndërsa vetë kaloi në pozicionin e Executive Chairman, ose drejtuesit ekzekutiv të bordit.

Sipas dokumenteve rregullatore të publikuara nga Apple, paga bazë vjetore e Cook në pozicionin e ri do të jetë 2 milionë dollarë, krahasuar me 3 milionë dollarë që mernte si CEO. Por pjesa më e madhe e paketës së tij nuk vjen nga paga. Për vitin fiskal 2027, Cook do të ketë një paketë aksionesh me një vlerë të synuar prej 45 milionë dollarësh, duke e çuar kompensimin total të synuar në rreth 47 milionë dollarë. Gjysma e kësaj pakete do të përbëhet nga aksione të kufizuara të lidhura me performancën e Apple. Përfitimi i tyre do të varet nga kthimi total për aksionerët e kompanisë në raport me kompanitë e tjera të indeksit S&P 500. Gjysma tjetër do të jetë e lidhur me kohën e qëndrimit në kompani dhe do të përfitohet gradualisht gjatë një periudhe katërvjeçare. Kjo do të thotë se shifra prej 47 milionë dollarësh është vlera e synuar e paketës së kompensimit dhe jo domosdoshmërisht shuma që Cook do të marrë automatikisht.

Nga 74 milionë dollarë si CEO në 47 milionë si Chairman

Edhe pse mbetet një paketë jashtëzakonisht e lartë, kompensimi i Cook do të jetë më i ulët krahasuar me vitet e fundit si CEO. Në vitet 2024 dhe 2025, kompensimi total i tij arriti në rreth 74 milionë dollarë në vit, duke përfshirë pagën, aksionet, bonuset dhe forma të tjera kompensimi. Megjithatë, madhësia e paketës së re tregon se Apple nuk e sheh pozicionin e Cook thjesht si një rol simbolik pas largimit nga drejtimi ekzekutiv. Përkundrazi, ai pritet të vazhdojë të ketë një rol të rëndësishëm në strategjinë dhe marrëdhëniet e kompanisë.

Lexo edhe: "Depresioni pas pushimeve": Pse shtatori na duket kaq i vështirë dhe si të rikthehemi në ritëm?

ABONOHU


Më të fundit



INOVATIVE 06/09/2026

556

"Shtëpia e së ardhmes"... AI, robotikë dhe teknologji inteligjente në IFA 2026



KARRIERA 06/09/2026

516

AI po i bën punonjësit të duken më të aftë se sa janë, 64% kryejnë detyra që nuk do t'i bënin dot vetë



john ternus merr drejtimin e apple

Ndërkohë, CEO i ri John Ternus do të ketë një paketë edhe më të madhe kompensimi. Apple ka përcaktuar për të një pagë bazë prej 3 milionë dollarësh në vit, së bashku me një paketë aksionesh me vlerë të synuar prej 55 milionë dollarësh për vitin fiskal 2027. Në total, kompensimi i synuar i Ternus arrin në rreth 58 milionë dollarë.

Rreth 75% e paketës së tij të aksioneve do të lidhet me performancën e Apple në bursë krahasuar me kompanitë e tjera të S&P 500, ndërsa pjesa tjetër do të përfitohet gradualisht përgjatë katër viteve. Ternus, një prej drejtuesve veteranë të Apple, ka drejtuar më parë sektorin e inxhinierisë hardware dhe ka qenë i përfshirë në zhvillimin e disa prej produkteve kryesore të kompanisë. Ai merr drejtimin në një moment të rëndësishëm për Apple, ndërsa kompania përballlet me presion në rritje për të përshpejtuar strategjinë e saj në inteligjencën artificiale dhe për të hapur një cikël të ri inovacioni në produktet e saj.

Cook nuk largohet realisht nga Apple

Paketa prej 47 milionë dollarësh është gjithashtu një sinjal i qartë se Apple dëshiron të ruajë përvojën dhe ndikimin e Tim Cook. Gjatë drejtimit të tij, Cook transformoi mënyrën se si Apple menaxhon prodhimin, shpërndarjen dhe zinxhirin global të furnizimit, ndërsa kompania u shndërrua në një prej bizneseve më të vlefshme në botë. Që nga momenti kur Cook mori drejtimin e Apple në vitin 2011, pas Steve Jobs, aksionet e kompanisë janë rritur me më shumë se 2,000%.

Ai ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në menaxhimin e marrëdhënieve të Apple me qeveritë dhe politikëbërësit në tregjet kryesore, veçanërisht në SHBA dhe Kinë. Pikërisht kjo eksperiencë pritet të mbetet një prej asetëve kryesore të kompanisë edhe pas kalimit të drejtimit operacional te Ternus.

Në këtë aspekt, tranzicioni i Apple ngjan me një model që është përdorur edhe nga kompani të tjera të mëdha: CEO largohet nga drejtimi i përditshëm, por qëndron pranë kompanisë në një rol strategjik për të garantuar vazhdimësi. Pas 15 vitesh si CEO, Tim Cook mund të ketë lënë zyrën kryesore të Apple, por paketa prej 47 milionë dollarësh dhe posti i ri tregojnë se ndikimi i tij në kompani është larg përfundimit.

BI

Që nga viti 2015 nxisim shpirtin sipërmarrës, inovacionin dhe rritjen personale duke ndikuar në zhvillimin e një mjedisi motivues dhe pozitiv tek lexuesit tanë. Mbështetja juaj na ndihmon ta vazhdojmë këtë mision.

Na Suporto



STRATEGY 04/09/2026 261

Pushimet po bëhen më të shkurtra, 3 ditë po mjaftojnë për një arratisje perfekte



LAJME 06/09/2026 422

Çmimet e prodhimit rriten lehtë, ndërsa hendeku mes tregut vendas dhe eksporteve thellohet

Related posts



TEKNOLOGJI 06/09/2026 363

OpenAI pranon "incidentin e Wiki"-t dhe premton një kuadër të ri për transparencën



TEKNOLOGJI 04/09/2026 556

Skandali që trondit botën e video-lojërave, të dhënat dalin në internet



TEKNOLOGJI 04/09/2026 761

Inteligjenca Artificiale shtrenjton produktet teknologjike, rriten çmimet e telefonave dhe laptopëve!



TEKNOLOGJI 04/09/2026

737

9 SHTATORI I APPLE! iPhone-i i palosshëm vjen me një surprizë që askush nuk e priste



TEKNOLOGJI 04/09/2026

659

Kujdes me llogarinë tuaj në X! Çfarë po ndodh pas lançimit të X Money?



TEKNOLOGJI 03/09/2026

239

Google prezanton Pics, mjetin AI që e kthen një prompt në dizajn

BUSINESS MAG NR. #42 – QERSHOR 2026

DIASPORA, pasuria e re strategjike e Shqipërisë!

Ekziston një paradoks në zemër të historisë ekonomike shqiptare të tridhjetë viteve të fundit. Vendi humbi dhe vazhdon të humbasë një pjesë të konsiderueshme të kapitalit të tij njerëzor që shkon drejt Evropës Perëndimore apo edhe Amerikës së Veriut. Ky proces, i dokumentuar me shifra alarmante është një plagë e hapur sociale e vendit dhe jo vetëm. Çdo vit Shqipëria dhe Kosova humbin mjekë, inxhinierë, sipërmarrës etj. Fitonin: remitanca.

Por kjo llogaritje gjithmonë ka qenë e paplotë. Dhe tani, me gjeneratën e parë të diasporës shqiptare që ka arritur maturinë profesionale dhe sipërmarrëse, po bëhet e qartë se sa e paplotë ka qenë në të vërtetë.

Krenar Komoni nuk e ndërtoi Tive-n, platformën teknologjike me vlerësim mbi gjysmë miliardi dollarë sepse sistemi e favorizoi. Përkundrazi, ai ia doli duke mbartur me vete kapitalin më të rëndësishëm: aftësinë për të parë mundësi aty ku të tjerët shohin boshllëqe. E njëjta histori përsëritet te Arber Sejdiu, sipërmarrësi nga Kosova që nga Zyrihu kontribuon në transformimin e retail-it global. Po ashtu, Eva Gjoni, Brendon Ahmeti i Synaps etj...Këta nuk janë përjashtime. Ata janë sinjalet e para të një fenomeni më të madh: kapitali shqiptar po krijon vlerë ...

[See more](#)



Weekly Newsletter - Bëhu Pjesë e Komunitetit
më të Madh të Sipërmarrjes në Shqipëri

Your name

Your email

SUBSCRIBE

Follow us



BUSINESS PULSE

Diaspora
EU Corner
Intervista
Lajme
Media&PR
Sipërmarrje
Startup

TEKNOLOGJI

High-Tech
Internet
Mobile
Shkence
Auto

PERSONAZHE

Sipërmarrës të suksesshëm
Shqiptarë Sipërmarrës në botë
Filantropë dhe bamirës të shquar

ZHVILLIM PERSONAL

Karriera
Këshilla suksesi
Marketing
Strategy
Enciklopedia e Biznesit
Edukim Financiar

PUBLIKIME BIZNESI

BUSINESS SHOP

Revista
Books
Llogaria ime
Shporta
Checkout
Kontakt
Termet & Kushtet
Shkruaj për Business Mag

Rr. Reshit Petrela,
kompleksi Usluga, Seksioni 3,
Tirane, AL
Tel: 067 20 11 531
Email: [\[email protected\]](mailto:)

Te gjitha të drejtat e rezervuara
(c) Business Mag Albania,
Business Consultant
Public Relations 2025

Your name

Your email

SUBSCRIBE

BM BUSINESS
MAGAZINE

© 2026 | Managed by [New Media Digtal](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.